

NË EMËRË TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtaret: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit F.T., nga fshati G. e U., komuna e L., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësja e të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR Prishtinë P.nr.862/2012 datë 22.06.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë PAKR.nr.427/2017 datë 30.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 28 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit F.T., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR Prishtinë P.nr.862/2012 datë 22.06.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë PAKR.nr.427/2017 datë 30.10.2017.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë P.nr.862/2012 datë 22.06.2017, i dënuari F.T., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK dhe për këtë veprë është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) €, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën e shqiptuar, e njëjta do ti shndërrohet në dënim me burgim duke i 'a llogaritur për çdo ditë burgimi, 20 € gjobë. Është detyruar që të paguaj shpenzimet e procedurë penale, aq sa do të jenë sipas llogaris përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 200 € brenda

afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Me të njëjtën aktgjykim, ndaj të pandehurit I.T., konform dispozitës së nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK, është refuzuar aktakuza për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.2 të KPK. Është vendosur që të konfiskohet arma CZ – 99 me numër serik 49658 e kalibrit 9 mm. me një karikator dhe një fishekë të njëjtit kalibër. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale, për ketë pjesë të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.427/2017 datë 30.10.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtëses se të dënuarit, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit S.M., avokate nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokurori i Shteti të Kosovës me parashtresën KMLP.II.nr.77/2018 datë 30.04.2018, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësja e të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitivave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPK, si në vijim:

- aktgjykimi i shkallës së parë është i pakuptueshëm sepse në hyrje të aktgjykimit mungon konstatimi se seanca është publike dhe data e përpilimit të aktgjykimit elementet këto të paraparë me nenin 370 par.2 të KPPK;

- se gjatë fjalës hyrëse, fare nuk ju ka mundësuar mbrojtëses që të jep fjalën e as pas deklaratimit të dënuarit më pas bënë interpretimin lidhur me rendin për paraqitjen e fjalës hyrëse në rastet kur i dënuari nuk ka mbrojtës dhe ato kurrë ka mbrojtës;

- dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm sepse theksohet se në vendin e ngjarjes janë sekuestruar 9 gëzhoja të armës së pa

identifikuar, ndërsa gjykata të dënuarin e shpallë fajtor bazuar në gëzhojat e gjetura pa vërtetuar se kush ka shtënë dhe nga e cila armë. Në vazhdim thekson se gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtjes që të bëhet ekspertiza mirëpo, mbrojtësja nuk e mohon faktin se për këtë është dhënë arsyetimi në faqen 6 të aktgjykimit kështu që si pasojë e kësaj nuk është vërtetuar lidhja kauzale në mesë të gëzhojave të gjetur dhe veprimet të dënuarit F.T., fakt ky relevant për vërtetimin e fajësisë së të dënuarit;

- dispozitivi i aktgjykimit është ndryshuar lidhur me veprimet inkriminuese të dënuarit të paraqitura në aktakuzën fillestare kështu që është humbur identiteti i akuzës kjo për faktin se në dispozitivin e aktakuzës qëndron konstatimi se i dënuari ja kishte shitur armën CZ-99 cal.9 mm., ndërsa në vendin e ngjarjes janë gjetur gëzhoja të kalibrit 9 mm., ndërsa nuk është vërtetuar se i takojnë të njëjtës revole;

- aktgjykimi i shkallës së parë bazohet ekskluzivisht në dëshminë e të dëmtuarës S.D., e cila deklaratë në fazat e ndryshme ishte kontradiktore lidhur me faktet relevante që kanë të bëjnë me elementin e kohës, sepse e njëjta në polici ka thënë se të shtënat janë dëgjuar rreth orës 03:00, kurse në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se të shtënat i ka dëgjuar rreth orës 24:00, deklaratë kjo e cila nuk është reale. Po ashtu thekson se edhe dëshmitarë të tjerë nuk kanë qenë të saktë lidhur me kohën kur janë dëgjuar të shtënat. Më pas mbrojtësja interpreton deklaratën e dëshmitarit A.D., për të theksuar se nuk përputhet me provat tjera kështu që vlerësimi i provave është në kundërshtim me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPK.

Për sa i përket shkeljes së ligjit penal, në kërkesë, theksohet se përkufizimi i veprës penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë dhe në rast të paqartësisë, interpretohet në favor të pandehurit kështu që në rastin konkret është shkelur parimi i ligjshmërisë nga nenin 1 par. 3 të KPK.

Në kërkesë potencohet se edhe aktgjykimi i shkallës së dytë është i pa ligjshëm sepse gjykata e shkallës së dytë, provat i ka vlerësuar në kundërshtim me dispozitat e KPPK, ndërsa për këtë nuk ka dhënë arsye në veçanti për provat kundërshtuese lidhur me kohën e kryerjes së veprës penale. Theksohet se e dëmtuara nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike e që është indikacion se sikur të kishte faj i dënuari, ajo do të paraqiste kërkesën në fjalë.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga këto arsye:

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, i dënuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, sepse ditën kritike me 18.01.2011 në kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv, nga një armë të pa identifikuar, në mënyrë kërcënuese ka shtënë disa herë në ajër në afërsi të shtëpisë A.D., me qëllim të

frikësimi të dëmtuarës S.D., për shkak të mosmarrëveshjeve që kishin në mesë vete si dashnor, ndërsa në vendin e ngjarjes janë gjetur 9 gëzhoja.

Nuk është i bazuar pretendimi se aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën hyrëse është i pa qartë, sepse qëndron fakti se në hyrje të aktgjykimit nuk qëndron konstatimi se shqyrtimi gjyqësor ka qen publik, po ashtu mungon edhe data e përpilimit të aktgjykimit, mirëpo këto të meta aktgjykimin nuk e bëjnë të pa qartë, madje as në kërkesë nuk është precizuar se në çfarë kuptimi këto të meta kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Sa i përket pretendimit të dytë, kjo gjykatë konstatoj se nuk është i bazuar sepse nga shkresat e çështjes dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 24.05.2017, rezulton se në fjalën hyrëse, mbrojtësja e të dënuarit nuk është deklaruar mirëpo është evidente se fjala i është dhënë të dënuarit dhe mbrojtësja nuk ka kundërshtuar një gjë të tillë e as që ka kërkuar fjalën, kurse nga ana tjetër ky pretendim nuk është mbështetur me ndonjë arsyetim se si ka ndikuar kjo në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Megjithatë, kjo gjykatë konstatoi se nuk është shkelur e drejta e të dënuarit në mbrojtje.

As pretendimi lidhur me cenimin e identiteti objektiv të akuzës nuk është i bazuar.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, me aktakuzën fillestare PP.nr.379-3/2011 datë 24.10.2012, janë akuzuar F.T. dhe I.T., ashtu që veprimet e tyre inkrimuese janë përfshirë me një dispozitiv, në të cilin ka qëndruar konstatimi se i dënuari F., ka mbajtur në pronësi pistoletën e markës CZ- 99, me numër dhe kalibër si në dispozitiv të aktakuzës fillestare, ndërsa F.T., është akuzuar për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, ndërsa I.T. për paragrafin 2 të njëjtës dispozitë ligjore.

Në shqyrtimin gjyqësor, Prokurori i çështjes pas administrimit të provave me që në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se i pandehuri I.T., armën në fjalë kishte blerë nga i dënuari para rastit kritik dhe ka qenë në posedim të armës deri ditën kur e njëjta i është konfiskuar, ka heqë dorë nga akuza në raport me të pandehurin I.T., për veprën e cekur penale me arsyetim se kjo vepër është përfshirë me amnisti sipas ligjit për amnistinë.

Sipas dispozitës së nenit 351 të KPPK, kur është fjala për ndryshimin dhe plotësimin e aktakuzës, duhet që në mes të përshkrimit fillestar të veprës dhe përshkrimit dhe precizimit në aktakuzën e ndryshuar të ekzistoj një identitet me ngjarjen themelore. Në rastin konkret precizimi i aktakuzës i bërë nga gjykata, është rezultat i provave të administruara, në veçanti raportit të nxjerrë në sistemin IBIS me datë 28.01.2015 të cilën e ka siguruar Prokurori i çështjes, nga i cili rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë me një armë tjetër e që është revole "Crvena Zastava M-57 e cal. 7.62x25 mm. pa numër serik me një karikator prej 9 fishekëve të njëjtit kalibër, gjë që e

bën të pa mundur realizimin e një ekspertize të krahasimit me armën e konfiskuar (nga I.T.), prandaj nuk është cenuar identiteti objektiv i aktakuzës. Nga ana tjetër, është irelevante a është gjetur arma apo jo, meqë i dënuari ka pasur kohë dhe mundësi të manipuloi me të. Në praninë e këtyre fakteve drejt ka vepruar gjykata e shkallës së parë, kur propozimin e mbrojtjes për caktimin e ekspertizës balistike ka refuzuar si të pa bazuar.

As pretendimi se provat nuk janë vlerësuar në pajtim me ligjin dhe se aktgjykimi bazohet vetëm në deklaratën e të dëmtuarës S.D., nuk është i bazuar për faktin se deklarata e të dëmtuarës, nuk është provë e vetme dhe e izoluar në këtë çështje penale, por përkundrazi, aktgjykimi bazohet edhe në prova tjera të administruara dhe atë në dëshminë e dëshmitarëve B.D., A.D. si dhe provat tjera materiale. Kështu nuk kanë qenë kontestues fakti se i dënuari dhe e dëmtuara S.D., ishin në lidhje dashurie dhe ca kohë para rastit kritik marrëdhëniet e tyre ishin acaruar për shkak të mosmarrëveshjeve. Nuk ishte kontestues as fakti se i dënuari para rastit kritik në tentimin e fundit që të rregulloj marrëdhëniet me të dashurën e tij, ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarës, kur pas bisedës me babanë e saj, ka kuptuar se lidhja e tyre ka marrë fund. Për të gjitha këto kanë dëshmuar dëshmitarët e cekur sikurse edhe për faktin se kjo nuk ishte hera e parë që i dënuari të vijë tek shtëpia e të dëmtuarës dhe të shtënë me armë. Faktin se natën kritike pikërisht i dënuari F., kishte përdoruar armën në mënyrë kërcënuese ka dëshmuar dëshmitari A.D., i cili në polici ka deklaruar se e ka parë të dënuarin natën kritike i cili me veturën e tij ka kaluar afër shtëpive kur janë dëgjuar të shtënat dhe se për këtë menjëherë e ka njoftuar babanë e të dëmtuarës-dëshmitarin B.D., i cili ka pohuar një gjë të tillë në deklarinimin e tij. Ky dëshmitar ka pohuar se ai personalisht e ka denoncuar të dënuarin në polici për këto veprime. Meqë ky dëshmitar, në shqyrtimin gjyqësor ka ndryshuar deklaratën, gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të dy deklaratave ka marrë si kredibile atë të dhënë në polici me 18.01.2011 për çfarë ka dhënë arsye në faqen 6 të aktgjykimit. Në këtë kontekst është vlerësuar edhe deklarata e të dëmtuarës S.D., prandaj të njëjtës gjykata ia fali besimin meqë përputhet edhe me prova tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor, ndërsa nga ana tjetër, dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, kanë demantuar mbrojtjen e të dënuarit i cili ka mohuar kryerjen e veprës penale. Vlen të theksohet se dallimet rreth kohës së saktë të shtënave, janë evidente sepse në deklarinimet e dëshmitarëve dhe të dëmtuarës, ekziston një mospërputhje, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se çështja e kohës ka të bëjë me perceptimin individual dhe lidhet me konceptin e orientimit në kohë të secilit person, prandaj këto dallimet nuk i bëjnë deklaratat e tyre kundërthënëse e as dispozitivin të pakuptueshëm, sepse nuk ka qenë kontestues fakti se rasti ka ndodhur natën kritike dhe afërsisht në kohën siç ka vërtetuar gjykata. Provat janë vlerësuar në harmoni me dispozitën e nenit 361 par.2 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK.

Bazuar në provat e administruara gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, pra, se i dënuari në kuadër të veprimeve inkriminuese, i mllafosur nga ndarja nga e dashura-e dëmtuara S.D., i armatosur me armë, shkon në afërsi të shtëpisë së sajë dhe dëshmitarit A.D., ashtu që të njëjtën e përdor në mënyrë frikësuese duke shtënë disa herë në ajër dhe largohet nga vendi i ngjarjes dhe rrjedhimisht drejtë është aplikuar ligji penal.

Këtë qëndrim lidhur me përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë, për çfarë ka dhënë arsye të qarta të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë. Pra, në bazë të provave të administruara dhe vlerësimit të drejt të tyre, drejt është aplikuar ligji penal.

Lidhur me pretendimet për shkeljen e ligjit penal, arsyet e dhëna në kërkesë lidhur me këtë bazë janë të paqarta, meqë potencohet se është shkelur dispozita e nenit 1 par.3 të KPK (parimi i ligjshmërisë), duke cituar dispozitën në fjalë për të theksuar se në rastin konkret çdo gjë është supozim dhe hamendje në atë çfarë thanë dëshmitarët, prandaj kjo gjykatë këtë pretendim refuzoj si të pa bazuar e kufizuar nga dispozita e nenit 436 të KPPK, e cila dispozitë në paragrafin 1 parashikon se me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

Nga arsyet e dhëna më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzua si e pabazuar dhe në pajtim dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Pml.nr.107/2018, më 28 maj 2018

Procesmbajtësja,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta